



Breaking News: Raporti i ngjarjeve, 7 nëntor 2024

⏏ ⏪ ⏩



07/11/2024

Kurbin/Ndërhyrja E Menjëhershme E Policisë, Parandaloi Ngjarje Kriminale Në Një Familje Në Mamurras

Kurbin/Ndërhyrja e menjëhershme e Policisë, parandaloi ngjarje kriminale në një familje në Mamurras.

Dhunoj bashkëshorten, si dhe kishte në banesë 2 armë gjahu dhe 455 fishekë armësh zjarri, arrestohet 40-vjeçari.

Gjithashtu, Policia i plotësoi 38-vjeçares, kërkesëpadinë për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes së menjëhershme, si dhe sekuestroi armët dhe municionin.

Si rezultat i reagimit të Komisarariatit të Policisë Kurbin, menjëherë pasi një 38-vjeçare kallëzoi se dhunohej nga bashkëshorti i saj, u mundësua kapja dhe arrestimi në flagrancë i këtij shtetasi, konkretisht Sh. R., 40 vjeç, banues në Mamurras. Gjithashtu, në vijim të veprimeve procedurale, u krye kontroll në banesën e të arrestuarit, ku u gjetën 2 armë gjahu, 300 fishekë automatiku dhe 155 fishekë pistolete, që mbaheshin pa leje, nga 40-vjeçari.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Lezhës, për hetime të mëtejshme, për veprat penale “Dhuna në familje”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”.



Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, gjatë 24 orëve të fundit

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, takim me Kryeprokuroren e Prokurorisë Federale të Mbretërisë së Belgjikës. ▶